



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

### Njoftim Për Shtyp

**Rasti: Përftimi i kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni që do të rezultojë në përfitim të kontrollit të plotë nga shoqëria Tyson Foods e disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.

Referuar “Marrëveshje Shitblerje” palët në marrëveshje janë:

*Pala Blerëse:* Tyson International Holding Co. është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të shtetit Delaware, e kontrolluar 100% nga Tyson Foods Inc, një shoqëri multinacionale e fokusuar në ushqime me përqendrim të lartë proteine.

*Pala Shitëse:* BRF GMBH është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Austrisë, e zotëruar 100% nga shoqëria mëmë BRF S.A. me objekt aktiviteti industrializim, shitje me pakicë dhe shumicë dhe shfrytëzim i ushqimit të përgjithshëm, veçanërisht produktet shtazore proteina dhe produktet ushqimore; ofrimi i shërbimeve të ushqimit në përgjithësi etj.

BRF Global GMBH është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Austrisë, e cila zotërohet 100% nga kompania BRF GMBH.

*Shoqëritë target:* Shoqëritë target janë aktualisht pjesë e grupit BRF, me seli qendrore në Brazil dhe janë përpunuese të integruara vertikalisht të pulave, me fabrika përpunimi në Tailandë dhe në Bashkimin Europian. Këto shoqëri importojnë dhe përpunojnë mish në Bashkimin Europian.

Më datë 07 shkurt 2019, është nënshkruar “Marrëveshje Shitblerje”, projekti Khan ndërmjet palëve (1) BRF GMBH (shitësi), (2) BRF S.A. (garantuesi i shitësit), (3) BRF Global GMBH, (1) Tyson International Holding Co (blerësi) dhe (2) Tyson Foods, Inc (garantuesi i blerësit).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**